



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

B.Curri me:18.01.2018

SHPALLJE

**PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL NË
POZICIONIN**

Përgjegjës i Sektorit Auditit brendshëm në Bashkinë Tropojë

Kategoria III-a/1

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit nr.242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropojë shpall procedurat e Lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për 1 (një) vend të lire në pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Auditit brendshëm Bashkia Tropojë - Kategoria: III-a/1

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË)
KONKURIMI APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE DERI ME DT.29.01.2018

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË DERI ME DT.02.02.2018

1 . LËVIZJA PARALELE

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është :

1-Hartimi i metodave apo udhëzimeve për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit apo akteve të tjera të Ministrisë së Financave, dhe dërgimi i tyre për miratim në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm;

2-Hartimi i planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

3-Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efijencës.

4-Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre audituese, si dhe dhënia e informacionit për Njesine e Harmonizimit.

5-Siguron drejtimin e njësisë Auditimit për përgatitjen e përditsimin e planeve dhe objektivave me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit kësaj strukture.

6-Është përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin e realizimit detyrave nga specialistët që drejton.

7-Jep detaje në fushen e auditimit për materialet që paraqiten në Këshillin e bashkise, titullarit institucionit apo në drejtorin e Harmonizimit auditimit brendshëm pranë Ministris Financave Auditimin e Brendshëm, për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre;

8-Përgatitja e raporteve, vjetore ose periodike, të cilat i dërgohen Njesisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe përmbajnë të dhëna për:

a-Angazhimet dhe objektin e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe, nëse ka pasur shmangie nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse.

b-Përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmirësim.

c-Veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.

ç-Raportimi, pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, të drejtuesi i subjektit të audituar, dhe i njësisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime, që përbëjnë vepër penale;
8-Dhënja e informacionit në linjë vartësie për realizimin e auditimeve të kryera sipas planit dhe propozimin e masave për riparimin e mangësive të konstatuara.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil .

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (III-a/1)
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" ose diplomë te barasvlefshme në (SHKENCA Ekonomike Ose Juridike) .(edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion;
- d-Të njoh programet bazë të kompjuterit .

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a – Jetëshkrim I plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b – Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë , duhet të përcillet edhe njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c – Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d – Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e – Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f – Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g – Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h – Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- I – Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet dates33e apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me poste ose dorazi prane zyres sekretari-arkivit

Bashkise për lëvizjen paralele duhet të bëhet dates4 dates: 29.01.2018

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31.01.2018** Njesia e burimeve njerzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe stenden e informimit te Publikut Bashkise, listën paraprake te kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e kriteret e posaaçme te lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga njesia e burimeve njerzore te Bashkise për shkaqet e moskualifikimit paraprak (nëpërmjet adresës së e-mail). Ndërsa me dt. **08.02.2018** do te shpallet lista e verifikuar per kandidatet qe plotesojne kushte dhe kriteret e veçantaper vazhdimin e konkurimit ,si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;I ndryshuar
- 3-Ligji 7961 dt.12.07.1995 I ndryshuar Kodi I punes ne Repupliken e Shqiperise.
- 4-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’per veteqeverisjen vendore”
- 5-Ligji nr. 9720, 4dt. 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin pubike për Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10318 date 16.09.2010;
- 6-Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin financiar publik.”
- 7-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- 8-Ligji nr.9367 dt.7.04.2005 “ per parandalimin e konfliktit interesir ne ushtrimin e funksioneve publike” .
- 9- Ligji për etiken

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE .

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e burimeve njerëzore e Bashkise do të shpallë rezultatin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.dhe ne Stenden e informimit publikut Bashkise.; Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedure do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e burimeve njerzore, për rezultatet e arritura prej tyre (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2. NGRITJA NE DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të lëvizjes paralele, rezulton se është ende i lire, ai është i vlefshëm për Vazhdimin e konkurimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë . Këtë informacion do ta merrni në Portalin e “Sherbimit Kombëtar të punësimit” dhe Stenden e informimit publikut te Bashkise, duke filluar nga data **08.02.2018**

Për këtë vend te lirë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse IV-a të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire.

2.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Ne zbatim te Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil “ neni 26 dhe V.K.M. 242 dt. 18. 03 .2015 kreu I III pikat 1 deri ne piken 43

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- 1 – Të jetë nëpunës civil konfirmuar, brenda kategorisë IV-a .
- 2 – Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

3- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mire” apo “shumë mire”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a – Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” ne Shkenca Ekonomike ose juridike (edhediploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë)

b – Të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion.

d-te njoh programet baz te kompjuterit

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave ne poste ose dorazi për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës:02.02.2018 prane sekretarisë arkivit Bashkisë Tropojë

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2018** Njësia e burimeve njerzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stenden e informacionit Bashkise listën paraprake te kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë, Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njesia e burimeve njerzore te Bashkise , për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

-Ndersa me dt. **22.02.2018** shpallet lista e verifikuar për ngritje në detyrë,po në këtë date do të njoftohet, vendi dhe ora e saktë për testimin me shkrim dhe intervisten e strukturuar me gojë per kandidatet qe kualifikohen.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Ligji 7961 dt.12.07.1995 “Kodi i punës në Republiken e Shqipërisë” i ndryshuar .
- 4-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’Për veteqeverisjen vendore”
- 5-Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik për Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 10318 date 16.09.2010;
- 6-Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin financiar publik.”
- 7-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- 8-Ligji nr.9367 dt.7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit interesit në ushtrimin e funksioneve publike
- 9- Ligji për etiken

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierë.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40** pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20** pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27.03.2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT .

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Portalit e shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe stenden e informacioneve për publikun të Bashkisë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme Portalin e “shërbimit kombëtar të punësimit”: dhe stenden e informimit public të Bashkisë Tropoje duke filluar nga data: **12.02.2018** e ne vazhdim.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e burimeve njerëzore do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Bashkia Tropoje do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. dhe në stenden e informimit publikut të Bashkisë.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE